



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and
Trade



Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

RAPORTI VJETOR I AKS 2023



Raporti vjetor i AKS - 2023 (Faqe 1)

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Agjencia Kosovare e Standardizimit, Rr. "Nezir Gashi" Lagja e Univerzitetit
10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës; Tel: + 381(0)38/512-779 E-mail: aksinfo@rks-gov.net

Përmbajtja:

1. Roli dhe rëndësia e AKS
2. Korniza ligjore e AKS
3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)
4. Komitetet Teknike (KT)
5. Standardet e adoptuara
6. Standardet e shfuqizuara
7. Standardet e shitura
8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit
9. Notifikimi i standardeve
10. Aktivitetet promovuese të AKS
11. Info Center
12. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS
13. Buxheti i AKS
14. Grupet punuese/komisionet
15. Raporte/kërkesa/takime
16. Trajnimet
17. Sfidat e standardizimit kosovar

1. Roli dhe rëndësia e AKS

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është i vetmi organ i administratës shtetërore për standardizim në Republikën e Kosovës, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. AKS siguron platformën për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miratton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit, ato që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit dhe standardet të cilat janë referencë në direktivat evropiane ose rregullore të transpozuar në legjislacionin vendor.

Standardizimi, është aktivitet i përcaktimit të rregullave për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, për probleme aktuale apo të tjera që mund të krijohen, që ka për qëllim arritjen e një shkalle optimale të rregullit në një kontekst të caktuar. Standardizimi realizohet me konsensus nga dhe për vetë palët e interesit, bazuar në gjithë përfshirje dhe transparencë.

Standardi, është dokument i hartuar me konsensus dhe i aprovuar nga një organ i njohur standardizimi, i cili ofron, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime apo karakteristika për aktivitetet apo rezultatet e tyre, që kanë për qëllim arritjen e një shkalle optimale rregulli në një kontekst të dhënë me të cilën pajtueshmëria është vullnetare.

Agjencia Kosovare e Standardizimit, është përgjegjëse për:

- ⇒ miratimin dhe mirëmbajtjen e standardeve kosovare dhe përditësimin e katalogut të standardeve;
- ⇒ shqyrtimin, mirëmbajtjen dhe konfirmimin periodik të statusit të standardeve kosovare në përputhje me rregullat dhe procedurat e standardizimit të miratuara nga AKS;
- ⇒ zhvillimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave mbi aktivitetet e standardizimit, në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- ⇒ përgatitjen, miratimin dhe publikimin e programit të punës për standardizim në përputhje me interesin e palëve;
- ⇒ hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin, ndryshimin, shfuqizimin dhe publikimin e standardeve kosovare dhe dokumenteve kosovare të standardizimit në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- ⇒ administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të standardeve;
- ⇒ administrimin dhe mirëmbajtjen e arkivit për standardet kosovare, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe shitjen e tyre në përputhje me ligjet, rregullat dhe politikat e zbatueshme të marrëveshjeve me organet e standardizimit;

- ⇒ ofrimin e shërbimeve të informimit për standardet dhe procedurat e standardizimit për subjektet afariste që kryejnë aktivitet ekonomik brenda dhe jashtë vendit;
- ⇒ të vepruar si pikë referimi për çështjet e ndërlidhura me standardizimin që rezultojnë nga marrëveshjet me organizatat evropiane dhe ndërkombëtare në lidhje me barrierat teknike në tregti dhe kodin e praktikës së mirë për hartimin, miratimin dhe publikimin e standardeve;
- ⇒ shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin në fushën e standardizimit me organet e huaja nacionale të standardizimit;
- ⇒ organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të ndërlidhura me standardizimin;
- ⇒ publikimin e buletinit dhe katalogut vjetor me standardet kosovare; dhe
- ⇒ iniciimin e studimeve, publikimeve, përvojës, punës kërkimore dhe aktivitete të tjera që kanë lidhje me standardizimin.

AKS, si organ i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit: CEN; CENELEC; ETSI dhe ISO; IEC; ITU, si dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standardet. Gjithashtu, është autoritet shtetëror i Notifikimit dhe Pikë e Referimit në OBT për standarde.

2. Korniza ligjore e AKS

Korniza ligjore e AKS:

- ⇒ Ligji nr. 06/L-019 për standardizim;
- ⇒ Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare për Standardizim (2020-2025);
- ⇒ Udhëzimi Administrativ nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit;
- ⇒ Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 për Logon e AKS;
- ⇒ Udhëzimi Administrativ nr. 16/2018 për Komitete Teknike;
- ⇒ Rregullore (QRK) nr. 28/2018 për mënyrën e notifikimit dhe ofrimit të informacioneve mbi rregulloret teknike, procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe standardet;
- ⇒ Rregullore e Brendshme nr. 01/2019 për standardet e harmonizuara kosovare;
- ⇒ Rregullore e Brendshme nr. 02/2020 për rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane si standarde kosovare;
- ⇒ Rregullore e Brendshme nr. 03/2022 për notifikimin e standardeve në CEN/CENELEC;
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë (DPS).
- ⇒ Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Institutit Maqedon të Standardizimit (ISRM).

- ⇒ Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe ASTM Internacional.
- ⇒ Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Institutit Austriak të Standardeve (ASI).
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Institutit Turk të Standardeve (TSE).
- ⇒ Marrëveshja Licencë ndërmjet CEN dhe AKS.
- ⇒ Marrëveshja Licencë ndërmjet CENELEC dhe AKS.
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Inspektoratit të Tregut (IT).
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Departamentit të Rregullimit të Tregut të Naftës.
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS), Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK) dhe Agjencisë të Metrologjisë së Kosovës (AMK).
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Departamentit të Industrisë (DI).
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- ⇒ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) dhe Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”.








Baza ligjore e AKS tashmë është e kompletuar dhe e përafuar me acquis të BE, megjithatë kërkohet plotësim i Rregullores (ZKM) Nr. XX/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.







3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)








Këshilli Profesional i Standardizimit është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AKS dhe si i tillë trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e komiteteve teknike. KPS gjatë vitit 2023 ka mbajtur dy takime të rregullta pune. Ky këshill së bashku me 20 komitetet teknike përbëjnë rreth 130 ekspertë të cilët aktivizohen në zhvillimin e standardeve dhe standardizimit në përgjithësi.

4. Komitetet Teknike (KT)

Komitetet Teknike janë grupe ekspertësh të deleguara nga institucione/organizata/ biznese publike ose private, të cilat veprojnë në fusha të caktuara të ekonomisë e që janë të përfshirë në procesin e standardizimit, respektivisht në hartimin dhe adoptimin e standardeve kosovare.

<p>KT. për Ndërtim, zhvillon standarde të cilat përcaktojnë karakteristikat e performancës dhe metodat e vlerësimit të produkteve dhe materialeve të ndërtimit. Këto standarde, gjithashtu mbështesin edhe implementimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative.</p>	
<p>KT. për Derivate të Naftës dhe Gazit, zhvillon standarde për të rritur cilësinë teknike, për të përmirësuar sigurinë, për të mundësuar reduktimin e kostove dhe për të zvogëluar ndikimin mjedisor në përgjithësi. Zbatimi i standardeve për derivate të naftës dhe gazit janë të rëndësishme edhe për rregullatorë dhe ligje në përgjithësi.</p>	
<p>KT. për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, dokumenton politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për një organizatë për të krijuar dhe ofruar produkte ose shërbime me cilësi të lartë për klientët. Standardet e SMC janë kritere ose rregulla të vendosura nga organizatat që ndihmojnë në përcaktimin e pajtueshmërisë përtej kufijve kombëtarë.</p>	
<p>KT. për Transport dhe Shërbime Postare, është sektor shumë i rëndësishëm në ekonomi. Kjo reflektohet në aktivitetet e standardizimit, të cilat mbulojnë transportin dhe çështjet horizontale, si ndërveprueshmëria, transporti intermodal, sistemet inteligjente të transportit dhe transporti i mallrave të rrezikshme.</p>	
<p>KT. për Elektroteknikë, zhvillon standarde të veçanta të cilat mund të përdoren për testime dhe matje të pajisjeve elektronike. Standardet mund të përdoren gjithashtu edhe si referenca teknike për montimin e pajisjeve elektronike, prodhimin e tyre dhe të gjitha aplikacionet që lidhen me to. LVD dhe EMC janë dy direktiva shumë të rëndësishme që i referohen standardeve të elektroteknikës.</p>	
<p>KT. për Metrologji, në vazhdimësi zhvillon standarde që i adresohen sigurisë së matjeve. Këto standarde, përveç që janë dokumente bazë për sistemet matëse, ato gjithashtu mbështesin edhe implementimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në metrologji.</p>	
<p>KT. për Shëndetësi, zhvillon standarde për vendosjen e kërkesave të sigurisë, cilësisë dhe performancës për pajisjet mjekësore, duke mundësuar qasje të sigurt në kujdesin shëndetësor. Kjo sigurohet nëpërmjet nxjerrjes në treg të pajisjeve mjekësore që plotësojnë kërkesat strikte të sigurisë, siç përcaktohet në tre direktivat e BE: Pajisjet mjekësore; Pajisjet mjekësore aktive të implantueshme; dhe Pajisjet mjekësore diagnostikuese in vitro.</p>	


<p>KT. për Energji, kontribuon në menaxhimin e energjisë duke mbështetur praktikat më të mira dhe duke u ofruar përdoruesve të energjisë mjetet e nevojshme për të analizuar dhe përshtatur modelet e tyre të konsumit të energjisë. Standardet janë një mjet fleksibël për të përmirësuar sigurinë dhe performancën, për të rritur efikasitetin e energjisë dhe për të mbrojtur konsumatorët, punëtorët dhe mjedisin.</p>	
<p>KT. për Përpunimin e Drurit, në vazhdimësi përgatit standarde që janë dokumente bazë për produktet e drurit, ato gjithashtu mbështesin edhe implementimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Përveç që është një sektor mjaft i rëndësishëm në industrinë dhe ekonominë e vendit, standardet ofrojnë zgjidhje pozitive mjedisore dhe të qëndrueshme në zhvillimin dhe ruajtjen e drurit.</p>	
<p>KT. për Makineri, jo vetëm që ka një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për sigurinë e një operatori, por gjithashtu kontribuon në mbrojtjen e mjedisit duke zhvilluar standarde që lejojnë prodhimin e makinerive të përshtatshme për mjedisin. Përfshinë lloje të ndryshme të makinerive industriale dhe shtëpiake, saldimit dhe makineritë e rënda (makina për miniera, ndërtim dhe bujqësi), ashensorët, rezervuarët dhe pajisjet nën presion.</p>	
<p>KT. për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion, zhvillon standarde të cilat adresojnë të gjitha rreziqet e mundshme që produktet e lodrave, pajisjeve sportive dhe rekreacionit mund të paraqesin për përdoruesit e tyre.</p>	
<p>Aktivitetet e KT. për Teknologji Agroushqimore në lidhje me sigurinë ushqimore janë në përputhje me objektivin e Bashkimit Evropian, të cilat kanë për qëllim të arrijnë nivelin më të lartë të mundshëm të mbrojtjes së shëndetit për konsumatorët.</p>	
<p>KT. për Miniera dhe Minerale, luan një rol kyç në mbështetjen e ekonomisë së vendit dhe është i dobishëm për shumë sektorë të tjerë, duke përfshirë edhe ndërtimin dhe industritë tjera. Kërkesa gjithnjë në rritje për minerale kërkon një përpjekje të lartë në standardizim, në lidhje me përcaktimin, klasifikimin, testimin, analizën dhe kërkesat teknike të shpërndarjes së produkteve të industrisë së minierave dhe mineraleve.</p>	

<p>Standardet e zhvilluara nga KT. për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë, përcaktojnë kërkesat për produkte që përdoren nga njerëzit në jetën e tyre të përditshme, duke përfshirë veshjet, aksesorët e modës, këpucët dhe artikujt prej lëkure. Këto standarde përfshijnë edhe kërkesat për projektimin, prodhimin dhe vlerësimin e performancës për produktet e destinuara për të gjitha kategoritë/konsumatorët.</p>	
<p>Standardet e KT. për Mjedis, ndihmojnë në trajtimin e ndryshimeve klimatike, garantojnë ruajtjen e mjedisit natyror dhe zbatimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe energjisë. Ato janë mjete kyçe që plotësojnë politikat kombëtare dhe evropiane që synojnë të udhëheqin tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër.</p>	
<p>KT. për Pajisje Mbrojtëse Personale, zhvillon standarde për të përmbushur kërkesat themelore të shëndetit dhe sigurisë në punë. Pajisjet Mbrojtëse Personale, mund të përdoren edhe për qëllime sportive ose aktivitete të tjera të ngjashme.</p>	
<p>KT. për Metale, Plastikë dhe Elektrike, zhvillon standarde në fushën e përçuesve metalik, plastikës, si dhe kablove dhe aksesorëve të tyre, si për tensionin e ulët ashtu edhe për atë të lartë. Gjithashtu zhvillon standarde të sigurisë dhe performancës për burimet e dritës si llambat LED dhe modulet LED, pajisjet e kontrollit elektronik dhe ndriçuesit, duke i sjellë ato në nivelin më të lartë të performancës dhe sigurisë me teknologjinë më të mirë të disponueshme në treg.</p>	
<p>Për KT. për Teknologji Informative, është veçanërisht e rëndësishme që produktet, sistemet dhe shërbimet të jenë reciprokisht të pajtueshme dhe të ndërveprueshme, në mënyrë që informacioni të mund të shpërndahet dhe njerëzit të mund të komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur pajisje të ndryshme.</p>	
<p>KT. për Eurokode, përmban një seri prej 10 standardesh evropiane, EN 1990 - EN 1999, të cilat ofrojnë një qasje të përbashkët për projektimin e ndërtesave dhe punëve të tjera inxhinierike civile dhe për produktet e ndërtimit gjithashtu. Eurokodet ndihmojnë për t'i bërë kompanitë më konkurruese dhe për të rritur sigurinë në industrinë e ndërtimit.</p>	
<p>Standardet e KT. për Turizmin, janë mjete që promovojnë komunikimin dhe ndërtojnë besimin midis klientëve dhe ofruesve të shërbimeve, duke lejuar kështu një vlerësim më të mirë të kërkesave të klientit dhe duke i mundësuar ofruesit të shërbimeve të japë një përgjigje më të shpejtë dhe më të përshtatshme. Është një sektorë në rritje dhe mjaft i rëndësishëm për ekonominë e vendit.</p>	

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur 54 takime të komiteteve teknike të ndryshme (tabela 1):

- KT për Mjedis (5);
- KT për Energji (2);
- KT për Ndërtim (3);
- KT për Makineri (3);
- KT për Shëndetësi (3);
- KT për Metrologji (5);
- KT për Turizëm (2);
- KT për Elektroteknikë (2);
- KT për Përpunim të Drurit (2);
- KT për Miniera dhe Minerale (3);
- KT për Teknologji Informative (3);
- KT për Teknologji Agroushqimore (3);
- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (3);
- KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (2);
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (3);
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (3);
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (4);
- KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (1);
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (2).

Tabela 1. Takimet e komiteteve teknike




5. Standardet e adoptuara

AKS në vazhdimësi zhvillon standarde të cilat janë me prioritet për ekonominë e vendit, industrinë dhe gjithashtu për plotësim të legjislacionit teknik me theks të veçantë për rregullore teknike të cilat i referohen standardeve. Janë gjithsejtë 535 standarde EN dhe ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK gjatë vitit 2023 (tabela 2):

- KT për Mjedis (90 SK)
- KT për Energji (12 SK)
- KT për Ndërtim (19 SK)
- KT për Makineri (21 SK)
- KT për Shëndetësi (15 SK)
- KT për Metrologji (69 SK)
- KT për Turizëm (7 SK)
- KT për Elektroteknikë (17 SK)
- KT për Përpunim të Drurit (14 SK)
- KT për Miniera dhe Minerale (22 SK)
- KT për Teknologji Informative (33 SK)
- KT për Teknologji Agroushqimore (12 SK)
- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (19 SK)
- KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (10 SK)
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (19 SK)
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (28 SK)
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (108 SK)
- KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (5 SK)
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (15 SK)

Tabela 2. Standardet e adoptuara SK




6. Standardet e shfuqizuara

Për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike (zyrtarët e AKS) në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet. Standardet mund të rishikohen edhe më shpejt nëse ka kërkesë nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale. Në total janë 1302 standarde kosovare të cilat janë shfuqizuar gjatë vitit 2023 (tabela 3):

- KT për Energji (48 SK)
- KT për Mjedis (40 SK)
- KT për Makineri (335 SK)
- KT për Metrologji (10 SK)
- KT për Shëndetësi (11 SK)
- KT për Elektroteknikë (328 SK)
- KT për Përpunimin e Drurit (10 SK)
- KT për Miniera dhe Minerale (70 SK)
- KT për Teknologji Informative (31 SK)
- KT për Teknologji Agroushqimore (119 SK)
- KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (103 SK)

- KT për Pajisje Mbrojtëse Personale (10 SK)
- KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (22 SK)
- KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (79 SK)
- KT për Transport dhe Shërbime Postare (50 SK)
- KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (26 SK)
- KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (10 SK)

Tabela 3. Standardet e shfuqizuara



7. Standardet e shitura

Standardet janë dokumente teknike të cilat zhvillohen në komitete teknike dhe pasi miratohen nga AKS bëhen publike për të gjitha palët e interesit. Çdo kush pastaj mund të blen standarde, e cila bëhet duke identifikuar standardet e dhura dhe duke drejtuar kërkesë në adresën aksinfo@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në zyrat e AKS ose edhe nëpërmjet telefonit 038/512-779, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin. Në total gjatë vitit 2023, janë shitur 122 standarde kosovare, në vlerën 2,503.50 € për biznese, individë apo institucione.

8. Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit, AKS shkëmben informacion në baza të rregullta me organizatat e standardizimit CEN/CENELEC; ASTM dhe DPS.

9. Notifikimi i standardeve

Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit, AKS është e obliguar të raporton lidhur me standardet e adoptuara dhe të shitura tek organizatat e standardizimit CEN/CENELEC; ASTM dhe DPS. Në këtë kuptim, AKS ka realizuar:

- Notifikimin e standardeve të adoptuara në CEN;
- Notifikimin e standardeve të shitura në CEN;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në CENELEC;
- Notifikimin e standardeve të shitura në CENELEC;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në ASTM;
- Notifikimin e standardeve të shitura në ASTM;
- Notifikimin e standardeve të adoptuara në DPS; dhe
- Notifikimin e standardeve të shitura në DPS.

10. Aktivitetet promovuese të AKS

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësishëm të standardeve dhe standardizimit në përgjithësi kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar online në:

<http://www.aks.rks-gov.net> dhe
www.facebook.com/MTI.AKS


Gjatë këtij gjashtë muaji të parë të vitit 2023, AKS ka publikuar dhe promovuar rolin dhe rëndësinë e standardeve nëpërmjet:

- Buletini i Standardeve (5; 6; 7 dhe 8).
- Katalogu i Standardeve Kosovare 2023.
- Dita Botërore e Standardeve.
- Udhëzuesi për shpërndarjen dhe shitjen e standardeve.
- Sesioni informativ për studentët e kolegjit UBT “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore - Kërkesat për çdo organizatë në zinxhirin ushqimor, bazuar në SK EN ISO 22000”.
- Promovimi tre ditor i standardeve të turizmit në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit.
- Sesioni informativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e standardeve për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike “Standardizimi dhe Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, bazuar në SK ISO 39001”.
- Sesioni informativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e standardeve për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike “Standardizimi dhe Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë - Kërkesat me udhëzime për përdorim, bazuar në SK ISO 45001”.

- Sesioni informativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e standardeve për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike “Standardizimi dhe Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit bazuar në SK ISO/IEC 27001”.
- Sesioni informativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e standardeve për bizneset në sektorin e përpunimit të drurit në Odën Ekonomike të Kosovës “Standardizimi dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë - Kërkesat bazuar në SK EN ISO 9001”.
- Sesione informative dy ditore për nxënësit e SHMT “Hoxhë K. Prishtina” për rolin dhe rëndësinë e standardeve.
- Sesioni informativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e standardeve për studentët e Akademisë Tempulli “Standardizimi dhe Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, bazuar në SK ISO 39001”.
- Standardet e harmonizuara për pajisjet elektrike dhe elektronike dhe standardizimi në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Projekti EU4Business: Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal.
- Sesione informative dy ditore për nxënësit e SHMT “Hoxhë K. Prishtina” për rolin dhe rëndësinë e standardeve.
- Standardizimi dhe standardet e harmonizuara për sigurinë e makinerive dhe komponentët e saja në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Projekti EU4Business: Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal.
- Aspektet legjislative dhe teknike lidhur me mirëmbajtjen, sigurinë dhe certifikimin e produkteve turistike të kurseve në litarë, në përputhje me praktikën dhe standardet ndërkombëtare.
- Praktikën e mira dhe zgjidhjet digjitale të përdorura në standardizim.

Foto nga promovimi i rolit dhe rëndësisë së standardeve





Gjithashtu, AKS ka kontaktuar, shqyrtuar dhe ofruar konsulencë për shumë institucione, kompani dhe biznesi të ndryshme, ku ju është dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, certifikimin, rregulloret teknike të cilat kanë referencë standardet, dhe të tjera sipas kërkesave, si: AAD Kosova SHPK; SharrCem; DoniTerm; Telos Labs LLC; Lika SHPK; Termokos; NT Sporting; Eramet Laboratory; Graniti SHPK; KEK; Mishel SHPK; Shalaj SHPK; Prishtina REA; Benewllc; Betonika; M-Technologie; IBMS; GIZ; Graniti Holding; Projekti CERP; ACL Concrete Test SHPK; Drita AAE; Kosova Lab; Ozon Space SHPK; INPO; Internacional Groupbase; ProGis; Eox Ballkan; Mat Testing Innovation; 3E Group SHPK; Akademia Tempulli; PBC SHPK; KIESA/MINT; DIC/MINT; AMK/MINT; DAK/MINT; DRSHM/MINT; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Mbrotjtjes; Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore; Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Doganat e Kosovës; etj.

11. Info Center

Agjencia Kosovare e Standardizimit, tashmë ka themeluar “Info Center” e cila ofron qasje të plotë për të gjitha palët e interesit, dhe atë jo vetëm për standardet e miratuara apo ato në procedurë, por edhe për kornizën ligjore; direktivat evropiane; këshillin profesional të standardizimit; komitetet teknike; fjalorin terminologjik të standardeve;

katalogun e standardeve; standardet në fuqi dhe ato të shfuqizuara; shitjen e standardeve; çmimet e standardeve; dhe publikime tjera, etj.

Kjo qendër informuese e bënë më të lehtë për të gjitha palët e interesit që të t'i qasen standardeve, gjithashtu e bënë më të lehtë qasjen dhe identifikimin e standardeve edhe për institucionet qeveritare, etj. Kjo mundëson që rregullatorët të harmonizojnë mjedisin rregullator, për të përmirësuar para shikueshmërinë dhe për të siguruar qartësi të të gjitha kërkesave teknike.

12. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS

Databaza e Standardeve Kosovare (Sistemi SMIS), siguron porosi online për shitjen e standardeve, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj bizneseve dhe çdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve. Gjithashtu kjo databazë, përmes lidhjes me ueb faqe, ofron identifikim më të lehtë të standardeve dhe lexim falas në zyre të AKS nga çdokush që është i interesuar për të lexuar tekstin e standardeve. Sistemi SMIS shfrytëzohet me “user name” nga i gjithë stafi dhe përmban aktivitete si:

- Plotësime të referencave të standardeve.
- Plotësime të “mirrore” të standardeve.
- Krijimi i user name dhe passwordit për palët e interesit.
- Krijimi i linçeve të reja në AKS ueb.
- Ndryshime të strukturës vizuale të AKS ueb.
- Identifikimi i problemeve në SMIS, mos shfaqja e standardeve në ueb të AKS.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk përputhen me çmimet.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk kanë pdf file.
- Futja e të dhënave në data bazë dhe identifikimi i standardeve të dublikuara.
- Identifikimi i standardeve të shfuqizuara.
- Përpilimi i listave në komitete teknike me standarde të shfuqizuara.
- Përpunimi i fjalorit terminologjik të standardeve.
- Identifikimi i standardeve të harmonizuara.
- Download i standardeve (CEN/CENELEC iProjex).
- Back Up System.

13. Buxheti i AKS

Shpenzimi i buxhetit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit për vitin 2023 është realizuar në shkallë të mjaftueshme. Nga gjithsejtë mallra dhe shërbime prej: 27,733.00 euro, janë shpenzuar 22,740.00 euro (82%).

14. Grupet punuese/komisionet

Zyrtarët e AKS kanë qenë mjaft të angazhuar nëpër grupe punuese dhe komisione të ndryshme brenda dhe jashtë AKS/MINT si:

- Grupi punues për koncept dokumentin për fushën e mbikëqyrjes së tregut.
- Grupi punues për Rregulloren (ZKM) nr. xx/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.
- Grupi punues për udhëzimin administrativ për caktimin e kushteve për vendosjen në treg të produkteve të parafabrikuara prej betoni-mbajtja e elementeve të murit.
- Grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ për formën dhe përmbajtjen e shenjës së konformitetit dhe mënyrën e njohjes së dokumenteve të huaja.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për kushtet për ofrimin e shërbimeve turistike të turizmit aktiv dhe aventuror.
- Grupi punues ndërmënor për Kapitullin 1 - Lëvizja e Lirë e Mallrave.
- Grupi punues për Këshillin Profesional të Akreditimit.
- Grupi punues për Planin e Performancës.
- Grupi punues ndërmënor për hartimin e ligjit për shërbimet private të sigurisë.
- Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ kërkesat tekniko-metrologjike për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore.
- Komisioni përzgjedhës për pozitën: Specialist i Prokurimit.
- Komisioni përzgjedhës për pozitën: Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Tregut.
- Komisioni për drejtorë në Bordin KRU Drini i Bardhë, Sh.A. Pejë
- Komisioni për emërim të TVK për pajisjet nën presion (ME).
- Komisionin për TVK për Identifikim Elektronik (ME).
- Komisioni për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026.
- Komisioni për Qasje në Dokumente Publike.
- Komisioni për të Dhënat Personale.
- Komisioni për emërim të TVK në fushën e produkteve të ndërtimit (MINT).
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e TVK për tahografë (MINT).
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e TVK për taksimetra (MINT).
- Komisioni profesional për ujën e destinuar për konsum njerëzor.
- Komisioni për Planin e Integritetit për AKS.
- Komisioni për regjistrim të rezervave shtetërore të produkteve të grurit (MINT).
- Komisioni për vlerësimin e ofertave për furnizim me produkte agro-ushqimore për nevojat e Rezervave Shtetërore.

15. Raporte/kërkesa/takime

AKS në vazhdimësi bënë raportim në baza të rregullta (javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore) dhe shqyrtim të kërkesave për të gjitha palët e interesit, si:

- Raport për inputet e KE për Kosovën.
- Raporte për PKZMSA; PRE; PKZH; PKIE.
- Raporti vjetor dhe plani i punës për KPS.
- Raporte mujore, tre mujore, gjashtëmujore dhe vjetore për aktivitetet e AKS.
- Raporte mujore dhe pagesa të ndryshme financiare.
- Raport për nën-komitetin e MSA për Tregti Dogana dhe Tatime.
- Planifikimi i prokurimit AKS 2023.
- Takime me akterë të tjerë dhe palë të interesit.
- Takime të rregullta me stafin e AKS.
- Referenca për anëtarët e Këshillit Profesional dhe Komiteteve Teknike.
- Takim me ASHI, për sistemin e-Kosova dhe ndërlidhjen me AKS-SMIS.
- Takim pune me përfaqësues të Projektit “Promoting Private Sector Employment” lidhur me inspektimin, mirëmbajtjen dhe kontrole nga aspekti i sigurisë për pajisjet bartëse të cilat përdoren për qëllime të sporteve zbavitëse.
- Pyetëtori i plotësuar lidhur me AKS (Infrastruktura e Cilësisë-GIZ).

16. Trajnimet

- ✓ Databaza SMIS
- ✓ Korniza ligjore e AKS
- ✓ Trajnimi për Menaxhimin e Performancës së Agjencie.
- ✓ Trajnimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS).
- ✓ Trajnimi për Mekanizmin e Zgjidhjes së Kontesteve/UNCTAD.
- ✓ Trajnimi për nxitjen e tregut të përbashkët rajonal nëpërmjet infrastrukturës cilësisë dhe tregtisë elektronike.
- ✓ Trajnimi për mangësitë dhe ngjashmëritë në kuadrin legjislativ, procedurat dhe praktikatat e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, metrologjia, akreditimi, dhe mbikëqyrja e tregut) nga të gjitha palët e CEFTA, si dhe si rekomandimet për rritjen e kapaciteteve të tyre për të siguruar përputhjen me BE me kërkesat dhe standardet në sektorin e makinerive, përfshirë edhe praktikatat në zbatimin e Direktivës së Makinerisë nga Shtetet Anëtare të BE.
- ✓ Vizita zyrtare në Institutin Austriak të Standardeve.

17. Sfidat e standardizimit kosovar

Korniza ligjore e AKS

Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë Kosovare për Standardizim.

Kapacitetet e stafit

Në mënyrë që AKS të njihet si partner i besuar në nivelin evropian dhe ndërkombëtar, duhet të ketë staf të mjaftueshëm, të përgatitur dhe të trajnuar mirë, me njohje të gjuhës angleze dhe kompjuterit. Aktualisht AKS ka kapacitete të limituara në këtë drejtim.

Mos anëtarësimi në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare

Në pamundësi për të qenë anëtarë në organizatat evropiane CEN/CENELEC dhe ndërkombëtare të standardizimit ISO/IEC, AKS është e kufizuar në arritjen e vizionit, misionit dhe objektivave të saj.

Databaza SMIS

Data baza aktuale SMIS (Standard Management Information System) është funksionale, mirëpo asaj i duhet mirëmbajtje të vazhdueshme (update + upgrade).

Adoptimi i standardeve

Për të ndjekur ritmet e zhvillimit të standardeve nga CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, AKS duhet të adoptoj një numër relativisht të madh të standardeve. Gjithashtu për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike (zyrtarët e AKS) në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet ose edhe më shpejt nëse ka kërkesa nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale. Një prej detyrave më të rëndësishme është të fitojmë qasje të plotë në standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe në “meta data”. Sigurimi i qasjes në standardet evropiane tashmë ka filluar duke u bazuar në marrëveshjen licencë me CEN/CENELEC, mirëpo e njëjta duhet të avancohet për shkak të implementimit relativisht të ngadaltë. Për pjesën tjetër të standardeve (ISO, IEC) ne kemi marrëveshje bashkëpunimi me DPS, por akoma jemi pa qasje të drejtpërdrejt në ISO dhe IEC.

Shitja online e standardeve

Është mundësuar vetëm porosia online e standardeve, ndërsa standardet akoma nuk shiten online si pasojë e sistemit elektronik por edhe për arsye të “copy right” (nuk kemi një program për të mbrojtur standardet nga kopjimi). Për të mundësuar plotësisht dhe përmirësuar mënyrën se si përdoruesit e standardeve të blejnë standarde, ne jemi në pritje edhe nga lidhja e databazës SMIS me ASHI (e-Kosova).

Administrimi i komiteteve ekzistuese

Menaxhimi i rreth 130 ekspertëve të angazhuar në 20 KT dhe përfshirja e palëve të interesit në veprimtarinë e standardizimit si dhe trajnimi i tyre mbetet sfidë për AKS.

Eurokodet

Mungesa e buxhetit dhe ekspertëve (profesionistëve të fushave përkatëse), janë ndër faktorët kyç në përgatitjen e anekseve kombëtare për eurokode.

Hapësira punese

Janë vetëm dy zyra ku vepron i gjithë stafi i AKS. Këto hapësira punuese janë shumë të vogla dhe si të tilla nuk mundësojnë zhvillimin e takimeve të KPS dhe KT, aktivitete të marketingut dhe promovimit, kurse trajnimi, sesione informative, etj.

Promovimi dhe ngritja e vetëdijes për të gjitha palët e interesit

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj zhvillimi i mëtejshmë i politikave dhe programeve të AKS, publikimi i materialeve promovuese (katalog, buletinë, udhëzues, etj.); dhe roli e rëndësia e standardeve dhe standardizimit në përgjithësi kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Këtu sfidë është edhe rritja e bashkëpunimit me ministrinë e linjës, institucionet dhe organizatat e subjektet të cilat i referohen standardeve.

Faktorët e jashtëm

- Mungesë e zhvillimit të industrisë dhe ekonomisë.
- Mungesë e bizneseve të mëdha.
- Mungesë e bizneseve prodhuese.
- Mungesë e bizneseve eksportuese.
- Mungesë e ekspertëve në fushën e standardizimit.